

MARRËDHËNIA E FESË ME SHKENCËN

Zoti i Lartësuar në Kuranin Famëllartë thotë:

“Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?”¹

Ndërsa kumtuesi i Shpalljes Hyjnore, Profeti Muhamed (a.s.), thotë:

“Nxënia e dijes është detyrë për çdo musliman e muslimane”.²

Kjo do të thotë që Shpallja Hyjnore e sheh marrëdhënien e fesë me shkencën si marrëdhënie të dyanshme. Feja që e ka burimin te Shpallja Hyjnore, është udhëndriçuese për njohjen e Zotit, kurse dijet shkencore argumentojnë se jeta dhe i gjithë universi ka një shpikës, krijues fillestar, superinteligjent, me dituri të pakufizuara që njihet me emrin “Zot”.

Pra, feja islame e konsideron shkencën si mjetin real për të kuptuar më mirë udhëzimet e Shpalljes Hyjnore, nga ku e merr burimin feja. Duke e parë në këtë këndvështrim, këto të dyja duhet të jenë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën, por jo gjithmonë ndodh kështu, si në rastin e teorisë së evolucionit nga Çarls Darwin, apo teoritë e disa filozofëve të shekujve XIX-XX, që mbështeten në filozofinë materialiste. Por, ka dhe shkencëtarë të tjerë, që mbështeten në origjinën hyjnore të jetës. P.sh. fizikani gjerman Maks Blank, e konsideron besimin te Krijuesi si atribut thelbësor të shkencëtarit. Ai thotë:

“Studimet serioze në çdo fushë të shkencës, lexojnë në ballin e tempullit të saj “Beso!”. Kurse për filozofin anglez Frensis Bejkan, “...ateizmi është vetia e njeriut me të mangëta shkencore, ashtu siç është besimi i palëkundur atribut i njeriut me dije të thella”.³

Për të arritur në besimin e vërtetë dhe të palëkundur, feja islame që e ka burimin nga Shpallja Hyjnore, e nxit njeriun të marrë njohuri mbi sistemin e krijimit, mbi mrekullitë në natyrë, mbi larminë e botës së gjallë, që ngado të hedhësh vështrimin, argumenton ekzistencën e Zotit si i vetmi

1 Kuran, surja El Alak, ajeti 5.

2 Ibn Maxhe Essunen Damask, Darul Fihh, s. 12, nr. 44.

3 Prof. Dr. Sokrat Ahmetaj, *Drita e Kuranit*, nr. 1, viti 2007, f. 30.

krijues, me dituri të pakufizuara dhe fuqi absolute. Kjo është lidhja që ekziston mes fesë dhe studimit shkencor që njih burimin hyjnor të çdo qenieje në këtë botë. Pra, vetë Zoti, që është një, pa fillim e mbarim kohor, e fton njeriun të vërë në veprim arsyen dhe aftësitë e tij për zbuluar të fshehtat e natyrës.

Kjo tregon se mendja është parësore dhe feja udhëndriçuese. Zoti në Kuran thotë:

*“A nuk e shikojnë ata me vëmendje nga qielli, se si Ne e kemi ndërtuar atë, se si e kemi zbukuruar atë, pa pasur asnjë zbrazëti?! Edhe tokën, se si e kemi shtrirë e në të kemi vendosur male përforcuese dhe kemi bërë që të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura? I bëmë ashtu, dëshmi të dukshme dhe kujtesë për secilin njeri që e ka drejtuar mendjen te Zoti”.*⁴

Ky ajet do të thotë se njeriu nuk mund ta udhëheqë e ta studiojë natyrën, para se të njohë dhe të zbulojë të mirat e saj. Ai duhet të njohë emërtimin e të gjitha gjërave, funksionin dhe dobitë e tyre në lidhje me jetën njerëzore, që t’i shfrytëzojë ato. Sa më thellë të futet dituria shkencore në fshehtësitë e natyrës, në ligjshmëritë e proceseve të saj, aq më e qartë bëhet përsosmëria e cilësive të Zotit dhe prania e tij. Në këtë mënyrë, krijohet lidhja e fesë me shkencën në të gjitha fushat e saj, si në fizikë, astronomi, biologji, kimi etj. Nëpërmjet tyre, shkencëtari zbulon bukurinë e veprave të Krijuesit, Zotit të Lartësuar. Shpallja Hyjnore, Kurani Famëlartë, e udhëzon njeriun të studiojë mrekullitë e natyrës. Pikërisht këto tregojnë praninë e Krijuesit.

Mjafton të marrim si shembull syrin e njeriut. Ai është mjeti më i rëndësishëm, që e lidh njeriun me mjedisin e jashtëm, por si është ndërtuar ai? Sigurisht, është shumë i përsosur, që nuk mund të ndërtohet vetë e me evolucion rastësor. Në pamjen më të thjeshtë, ne shohim shtatë shtresa: lëkura, konjuktivi, sklera, kornea, irisi, kristalini dhe retina. Nga ana e tyre, secila shtresë ka një ndërtim të mahnitshëm. Këtu veprojnë disa ligje të fizikës dhe të kimisë, që kanë lidhje me dritën dhe reflekset e saj. Mbi këtë model janë bërë aparate të veçanta, por që nuk barazohen asnjëherë me këtë organ prej mishi, të krijuar nga vetë Zoti. Kjo vërteton edhe një herë, se dituria e Zotit është e pakufizuar. Ai ndërtoi syrin te njeriu, që është një organ i perfeksionuar, i cili filmon çdo ditë me miliona pamje, në saj të hapjes së bebes së syrit që punon në mënyrë automatike, përballë ndryshimit të dritës.

4 Kuran, surja Kaf, ajetet 6-8.

Nuk po i përmendim të gjitha, por po veçojmë së fundmi lotimin, proces që përbëhet nga disa elemente të cilët përbëjnë ilaçin më të përsosur për ta mbrojtur syrin nga tharja, që e dëmton shumë atë.

Zoti në Kuran thotë:

“Kur dëgjojmë për atë (Kuranin) që i është zbritur të dërguarit, i sheh se si rrjedhin lotët nga sytë, për shkak të vërtetës që kuptuan”.⁵

Mirëpo, shkenca ka zbuluar këtë të vërtetë, se lotët që dalin nga sytë, qoftë edhe për të qarë, shërojnë edhe disa çrregullime psikologjike që shfaqen te njeriu. Ato jo vetëm i pastrojnë sytë, por largojnë edhe depresionin. Ky është Allahu që i dhuroi njeriut lotin, si mirësi të madhe për të mbrojtur syrin. Edhe një herë, me këtë shembull konkret, treguam lidhjen e Shpalljes Hyjnore me studimin shkencor, në funksion të dobisë së njeriut. Në këtë rast, në mbrojtjen e këtij organi të specializuar që e lidh njeriun me botën e jashtme, i jep mundësi atij të vrojtojë, zbulojë dhe argumentojë ekzistencën e Zotit të Lartësuar.

Duke njohur fshehtësitë e natyrës, ligjshmëritë dhe proceset e saj, bëhet gjithmonë e më qartë prania e Krijuesit, Zotit të Lartësuar. Kjo tregon se, pa njohjen e veprës, nuk mund të njihet dhe Krijuesi i saj. Dhe disiplinat e ndryshme shkencore si fizika, biologjia, kimia, astronomia etj., na zbulojnë përsosmërinë e cilësive të Zotit, të krijimit, të dijes, vullnetit dhe të fuqisë absolute. Atëherë, mund të themi se shkenca është mjete real më i afërt që të çon në ekzistencën e Krijuesit, Zotit të Madhërisëm. Ndërsa për njerëz që nuk kanë dije të thella shkencore dhe mohojnë Krijuesin, duke ia atribuar gjithçka evolucionit të materies, Zoti në Kuran thotë:

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, sepse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto kanë përgjegjësi”.⁶

Ndërsa në një citim tjetër, thuhet:

“E supozimi nuk është asgjë ndaj të vërtetës”.⁷

Kjo do të thotë se, pa njohur mirë të vërtetën, nuk mund të bëhen pohime shkencore. Shpallja Hyjnore i nxit njerëzit të marrin njohuri mbi sistemin e krijimit, mbi mrekullitë në natyrë, mbi larminë e botës së gjallë, që, ngado të hedhësh vështrimin, gjen shenja të Krijuesit, Zotit të Lartësuar. Pra, e fton njeriun që të vërë në veprim arsyen dhe aftësitë e tij për të

5 Kuran, surja El Maide, ajeti 83.

6 Kuran, surja Isra, ajeti 36.

7 Kuran, surja Junus, ajeti 36.

zbuluar të fshehtat e natyrës. Marrim si shembull botën e gjallë bimore që përfshin shumë degë të shkencës. Bimësia merr pjesë në formimin e dherave, ndihmon përbërjen e ajrit, shërben si ushqim për kafshët, thith prej tokës substanca dhe i kthen në lëndë organike. Ndërsa faktorët që veprojnë në jetën e bimëve, janë të ndryshme, si: kushtet klimaterike të vendit, relievi, bota organike, dherat, veprimtaria e njeriut etj. Nxehtësia është faktori më i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Vetëm në dritën e diellit bimët e blerta mund të krijojnë substanca organike nga ato inorganike, nëpërmjet procesit të fotosintezës. Pra, çdo faktor i përcaktuar nga studiuesit të çon te një Krijues i vetëm. Ky është Zoti i Lartësuar që i ka krijuar në ekuilibër të plotë këta faktorë të domosdoshëm për jetën.

Në asnjë mënyrë, nuk mund të pranohet se këto kanë ardhur në mënyrë të rastësishme, pa një program të paramenduar. A mund të pranojmë se planeti i Tokës ka një distancë të caktuar me planetin e Diellit në mënyrë të rastësishme? Po burimi i energjisë së diellit në formën e ngrohtësisë së dritës? Po Toka që lëviz në orbitën rreth Diellit me shpejtësi të caktuar e rrotullohet rreth boshtit të saj çdo 24 orë? Po atmosfera mbrojtëse e tokës që mbështet jetën në të? ... E shumë pyetje të tjera, akoma më të ndërlikuara, që argumentojnë ekzistencën e Zotit.

Zoti në Kuran thotë:

"Është fakt, se në krijimin e qiejve dhe tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijeve që lundrojnë në det, që u sjellin dobi njerëzve, në atë ujë që lëshon Allahu prej së larti e me të ringjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe të reve të nënshtruara mes qiellit dhe tokës (në të gjitha këto) ka argumente për një popull që ka mend".⁸

Këto dije shkencore janë elemente për njohjen e madhësisë së Krijuesit, Zotit të Lartësuar. P.sh.: drita e diellit është e domosdoshme për jetën e bimëve. Toka merr nga dielli një sasi të madhe nxehtësie për të krijuar kushte të përshtatshme jetese për qeniet e gjalla në tokë. Por dielli me tokën kanë ekuilibrin e caktuar, ndryshe do të ndryshonin të gjitha kushtet e jetës. Prandaj dhe Zoti në Kuran thotë:

"Edhe Dielli udhëton ashtu si i është përcaktuar rruga e vet. Ky është përcaktimi i të Diturit, Ngadhënyesit".⁹

⁸ Kuran, surja El Bekare, ajeti 164.

⁹ Kuran, surja Jasin, ajeti 38.

Shembujt janë të shumtë, në të vërtetat shkencore që argumentojnë ekzistencën e Zotit. Çdo shkencë e fushave të ndryshme është mjet për të arritur afërsinë me Allahun e Lartësuar. Ato nuk janë të huaja me të dhënat e Shpalljes Hyjnore. Përkundrazi, ato iu paraprijnë atyre, duke vlerësuar vrojtimin, zbulimin dhe eksperimentet, si shenja të Zotit në të gjithë universin.

Në qoftë se do të vështronim me kujdes çdo gjë rreth nesh, patjetër që do të na shkonte në mendje, se këto fenomene kaq të bukura e të përsosura nuk kanë lindur vetvetiu, por kanë një Krijues. Ky patjetër, duhet të jetë një arkitekt shumë i përsosur, që e ka mundësuar jetën sipas një ndërtimi strukturor shumë të detajuar në organe specifike, që i përshtaten kushteve të jetës.

Në Kuran thuhet:

*“Është Zoti që krijoi çdo gjë dhe e pajisi me cilësitë dhe veçoritë e nevojshme që pëlqen Ai vetë”.*¹⁰

Kjo do të thotë se asgjë në këtë botë nuk ka ardhur në mënyrë të rastësishme, por që nga qeliza, njësia bazë e çdo organizmi, çdo gjë është e krijuar. Ajo nuk mund të marrë gjallërinë vetvetiu e pastaj të punojë si një “fabrikë” komplekse, duke siguruar ushqimin, ta asimilojë, të nxjerrë jashtë mbeturinat, të zhvillojë aktivitetin seksual, edhe pse nuk ka organe etj.

Ç’mund të themi për kodin gjenetik që nuk e ka të barabartë asnjë gjallesë në tokë, por secila ka kodin e saj specifik?! Këtë e shohim te njeriu, dhe kriminalistika po e përdor si mjet identifikimi për secilin.

Fizikani H. S. Simpson thotë:

*“Shpjegimi i vetëm i pranueshëm është krijimi”.*¹¹

Ndërsa astronomi Robert Xheistron thotë:

*“Shkencëtarët nuk kanë asnjë provë, se jeta nuk është pasojë e një akti krijimi”.*¹²

Në Kuran thuhet:

*“Thuaj: Ai (Allahu) është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. Ai s’ka lindur ndonjë dhe as është i lindur. Dhe me të, askush nuk është i barabartë”.*¹³

10 Kuran, surja El Furkan, ajeti 2.

11 H. Simpson, 1980, vëll. 31, f. 138.

12 Robert Xheistron, 1981, f. 19.

13 Kuran, surja El Ihlas, ajetet 1-4.

Kjo thënie tregon se Allahu është i vetmi krijues me intelektin universal, që u jep frymëzim krijesave të veta dhe i drejton në ciklin e zhvillimit të plotë, duke i furnizuar me mjetet e nevojshme jetësore të kësaj bote. Pra, Ai është një i vetëm, i gjithëfuqishëm, me dituri të pakufizuara, në të dëgjuar e të gjithëshikuar, pa organe, që jep attribute në krijesa dhe në lidhje të pandërprerë me krijesat e tij. Allahu është identitet absolut, që i përmbledh të gjitha cilësitë e plotësimit dhe nuk mund t'i atribuohet asnjë mangësi. Ai është i pashpërbërë dhe, si i tillë, nuk mund të lindë prej tij asnjë send dhe as mund t'i ndahet ndonjë send. Prandaj, pa asnjë dyshim, është Krijuesi i çdo sendi dhe pika fillestare e të gjitha qenieve. Për këtë, në Kuran thuhet:

*“Edhe tek Ai janë çelësat e fshehtësisë, atë nuk e di askush përveç Tij”.*¹⁴

Këto njohuri i marrim nëpërmjet fesë që e ka burimin te Shpallja Hyjnore. Pra, feja, me të gjitha sistemet e saj morale dhe, mbi të gjitha, me orientimin e mendjes njerëzore drejt Zotit, është shkaku primar i çdo qenieje dhe energjie pozitive që na nxit për dituri, pa dallim gjinie dhe race. Si rezultat, kanë dalë shumë dijetarë në fusha të ndryshme të shkencës.

Shkenca, në vetvete, është një sistem dijesh e njohurish për ligjet e zhvillimit të natyrës e të shoqërisë, të formuara gjatë historisë njerëzore, nëpërmjet vëzhgimit të botës reale. Mbi këtë bazë janë bërë përgjithësime teorike në degë të ndryshme specifike shkencore. Një shkencëtar i kohëve të fundit, Michi Kahn, lindur në vitin 1947, ka deklaruar se Zoti ekziston dhe për këtë, kishte prova. Ai thotë:

*“Më besoni: gjithçka që deri më sot e kemi quajtur rastësi, nuk do të ketë më asnjë kuptim, për mua është e qartë se ne drejtohem sipas rregullave të krijuara dhe jo të përcaktuara sipas mundësive universale. Për këtë, njerëzimi është një lloj Matrixi dhe Zoti është matematikan i madh”.*¹⁵

Po kështu edhe fizikani dhe kozmologu anglez, Steffen Hawking, i lindur në vitin 1942, mbas një qëndrimi shumëvjeçar si ateist, ka ndryshuar mendje rreth kësaj teme dhe ka pohuar:

*“Po! Zoti ekziston”.*¹⁶

14 Kuran, surja El En'am, ajeti 59.

15 Michi Kahn, *Feja dhe shkenca - kundërshtare apo bashkudhëtare*.

16 Po aty.

Pohimi i tij do të thotë se shkencë studioi ligjet e Krijuesit në këtë botë dhe përqipet t'i vërë ato në shërbim të njeriut. Shkencëtari i madh Albert Ajnshtajn (1879-1955) ka thënë:

*“Shkencë pa fenë, është e çalë dhe feja pa shkencën, është e verbër”.*¹⁷

Po sjellim dhe dy shembuj të thjeshtë nga një personalitet akademik, mjek dhe shkencëtar, i cili thotë:

“Pyeta mbesën time: “A beson te Zoti?” Ajo u hodh përpjetë, si me sustë:

“Sigurisht që po”! Dhe më pas, duke mbajtur frymën shtoi: “Se kështu më ka thënë nëna”! Por unë mora një nga librat e saj dhe e pyeta: “Kush e ka shkruar këtë libër”? Ajo menjëherë lexoi emrin e autorit. Duke vijuar bisedën, i thashë: “Zëre se grisa kapakun e librit që ka emrin e autorit dhe të them se ky libër u shkrua vetë, pa pasur një shkrimtar, ç’do të thoshe”?

*Përgjigjja e saj ishte, sigurisht, këmbëngulëse: “Kjo është e pamundur”! Vazhdimi i diskutimit tonë qetë-qetë, ishte se, sikundër libri është provë e një shkrimtari, po ashtu edhe krijesa është dëshmi e Krijuesit”.*¹⁸

Në një rast tjetër, ai thotë se nuk mund ta mendojmë gjithësinë pa Zot.

*“U habita kur mora vesh se shumë nga bashkëpunëtorët e mi shkencëtarë në qarqet akademike, në Amerikë dhe në Europë, jo vetëm nga blloku ish-komunist, ishin ateistë... Një mbrëmje, hapa fjalorin për të parë kuptimin e një fjale dhe një ide më erdhi në mendje: - Ta zëmë se dikush më sugjeroi se vendosja e pagabueshme e fjalëve në fjalor ishte pasoja e një shpërthimi në shtypshkronjë, gjë e cila bëri që shkronjat e plumbit të kërcenin përpjetë në ajër, pastaj të binin ashtu, në rend alfabetik, siç hasen në fjalor. Këtë nuk e gëlltisja dot”!*¹⁹

Nga këta shembuj që përmendëm, secili duhet të krijojë bindjen, qoftë dijetar apo shkencëtar, se asnjë send në botë nuk mund të jetë krijuar pa ndërhyrjen hyjnore. Atëherë duhet t'i drejtohem vetëm një Krijuesi

17 Po aty.

18 Hassan Hathout, *Leximi i mendjes së muslimanit*, botues: AIITC, kreu i parë, f. 1.

19 Po aty, f. 2-3.

që ekziston nga vetvetja, pa fillim e pa fund, dhe të gjitha qeniet e tjera janë të varura prej tij. Dhe ky është Zoti. Besimtari i devotshëm është i mobilizuar në jetë, e falënderon Zotin që e bëri krijesën më të përsosur në botë dhe ndjehet i lumtur për gjithçka i ka dhuruar. Kështu, ai arrin të krijojë qetësi shpirtërore dhe trupore, duke ruajtur gjithmonë freskinë që i jep mbështetja te Krijuesi i tij.

Fiziologët në librin “Bazat e anatomisë dhe të fiziologjisë”, thonë:

“Motivimi dhe parashikimi për të planifikuar dhe filluar lëvizjet ndodhen në pjesën e përparme të lobeve balllore, në zonën parabollore. Për shkak se zona parabollore merr pjesë në motivim, mendohet se ajo është qendra përgjegjëse për agresionin”.²⁰

Kjo do të thotë se, në qoftë se njeriu nuk beson, atëherë në trurin e tij ka reflekse negative që e çojnë në vepra të këqija, madje deri në ato kriminale. Ndërsa, kur beson te Zoti, motivi për jetën është i qartë, pozitiv dhe ndikon tërësisht në shëndetin mendor dhe fizik të tij.

Për këtë, Zoti në Kuran thotë:

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje”.²¹

Kjo do të thotë se sjellja e njeriut që e ka mbushur ndërgjegjen e tij me besimin te Zoti, në marrëdhëniet ndërnjerëzore, është shumë e mirë. Kjo për faktin, se ai në ndërgjegjen e vet frenon çdo pasion negativ, duke treguar një moral të lartë të besimit të tij, të frymëzuar nga Shpallja Hyjnore. Energjitë që jep besimi në Zot, e bëjnë trupin e tij të shëndetshëm fizikisht dhe psikologjikisht, duke i siguruar qëllimin bazë të mobilizuar, për të cilin ai u krijua. Asnjë njeri që nisat nga motive të pandershme në jetë dhe që për ta ndërtuar atë bën veprime që janë të ndaluara nga ligjet e Shpalljes Hyjnore dhe nga ato të shtetit në të cilin jeton, nuk do të triumfojë. Përkundrazi, këto motive do të bëhen faktorë për shkatërrimin e tij si njeri. Prandaj duhen edukuar brezat e rinj me ndjenjën e besimit, që i përgatit të gjitha dëshirat për jetën në drejtimin pozitiv dhe jo negativ. Besimi forcon dinjitetin dhe vendosmërinë për të përballuar çdo pengesë që iu del njerëzve përpara gjatë rrjedhës së jetës.

²⁰ Po aty, f. 43.

²¹ Kuran, surja El Isra, ajeti 82.

Bibliografia

1. *Kuran, surja El Alak ajeti 5.*
2. *Ibn Maxhe Essunen Damask Darul Fihh, s. 12, Nr. 44.*
3. *Prof. Dr. Sokrat Ahmetaj, Drita e Kuranit, Nr. 1, 2007, f. 30.*
4. *Kuran, surja Kaf, ajete 6-8.*
5. *Kuran, surja El Maide, ajeti 83.*
6. *Kuran, surja Isra, 36.*
7. *Kuran, surja Junus, ajeti 36.*
8. *Kuran, surja El Bekare, ajeti 164.*
9. *Kuran, surja Jasin, ajeti 38.*
10. *Kuran, surja El Furkan, ajeti .2*
11. *H. Simpson, 1980, vëll. 31, f. 138.*
12. *Robert Xheistron, 1981, f. 19.*
13. *Kuran, surja El Ihlas, ajetet 1-4.*
14. *Kuran, surja El En'am, ajeti 59.*
15. *Michi Kahn, Feja dhe shkencë- kundërshtare apo bashkudhëtare.*
16. *Hassan Hathout, Leximi i mendjes së muslimanit, kreu i parë, f. 1.*
17. *Kuran, surja El Isra, ajeti 82.*